



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 31, datë 23.06.2025

**PËR MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS “FUQIZOJMË KOMUNITETIN”
ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT
PËR VITET 2025-2027 DHE BUXHETI I BASHKISË Durrës**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratën e Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, Ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr.658, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”, Udhëzimit nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Qendrat Komunitare shumëdisiplinore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.95, datë 28.10.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Bashkisë dhe UNDP Shqipëri nr.2327 prot., datë 01.03.2023, Marrëveshjen e bashkëpunimit nr 605, datë 15.01.2025 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror “Për zbatimin e projektit “Shërbim i integruar për fuqizimin e individëve në nevojë”si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e funksionimit të Qendrës “Fuqizojmë Komunitetin” me një strukturë prej 15 punonjësish.

2. Miratimin e fondit prej 10,278,097 lekë për financimin e shpenzimeve të personelit për Qendrën “Fuqizojmë Komunitetin” për vitin 2025.
3. Miratimin e përdorimit të fondit prej 6,610,177 lekë, që financohet nga Fondi Social i buxhetit të shtetit për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 7 punonjës.
4. Miratimin e fondit prej 3,667,920 lekë, që do të financohet nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, që do të përdoret për financimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) për 8 punonjës, si më poshtë:

Kodi Njesisë shpenzuese	Njësia shpenzuese	Program buxhetor	Llogaria ekonomike	Fondi
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	600	3,143,050
2107017	Qendra Ditore të Moshuarve	10430	601	524,870

5. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
6. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ditore e të Moshuarve, Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës



Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.06.2025




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 426 / 3 prot.

Durrës, më 27.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.31 datë 23.06.2025 ,” Për miratimin e funksionimit të qendrës “Fuqizojmë Komunitetin”, me mbështetjen nga programi i fondit social të buxhetit të shtetit për vitet 2025-2027 dhe buxheti i Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

